



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

VENDIM

nr. 321, datë 01/07/2014

“Për

shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “ Rapiscan Sustems ICN” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 319, datë 13.06.2014 “ Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”

Komisioni i Konkurrencës, me përberjen e:

Lindita	MILO(LATI)	Kryetar
Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.07.2014, me pjesmarrjen e Znj. Lindita Milo(Lati), Znj. Servete Gruda, Znj. Iva Zajmi, dhe Z. Koço Broka, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes “Rapiscan Systems ICN” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 319, datë 13.06.2014 “ Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 2, germa c, neni 24, germa d, dhe neni 46 .

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të

- Kërkesës së ndërmarrjes “Rapiscan Sustems ICN” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 319, datë 13.06.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në

Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit” si dhe Relacionit të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës për këtë kërkesë,

VËREN SE:

1. Më datë 25.06.2014, pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar një kërkesë nga ndërmarrja “ Rapiscan Systems ICN” me atë të të cilës kjo ndërmarrje kërkon revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 319, datë 13.06.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”
2. Autoriteti i Konkurrencës e ka nisur procedurën e vlerësimit ex-post të kontratës koncensionare në zbatim të nenit 2, pika 1, germa c) dhe nenit 69, pika 1 germa b) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).
3. Autoriteti i Konkurrencës ka detyrimin ligjor të vlerësojë shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës edhe në tregjet në të cilat janë dhënë të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose produkte të caktuara, duke dhënë edhe mendime dhe rekomandime në lidhje me këto të drejta. Ky vlerësim realizohet edhe për zbatimin e Politikës Kombëtare të Konkurrencës për liberalizimin e tregjeve, detyrim që rrjedh edhe nga proceset e integritimit në Bashkimin Europian.
4. Revokimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës mund të bëhet vetëm nëse plotësohet njëri nga kriteret e parashikuara në nenin 46 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Sipas këtij neni, Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:
 - a) njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit kanë ndryshuar;
 - b) palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
 - c) vendimi është bazuar në të dhënat jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.

Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjes “Rapiscan Systems ICN” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 319, datë 13.06.2014 “ Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit” dhe i argumenteve të dhëna nga kjo ndërmarrje, konstatohet se nuk ndodhemi para kushteve të sipërcituara. Pra, në kuptim të nenit 46 të Ligjit 9121, datë 28.09.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kërkesa e ndërmarrjes “Rapiscan Systems ICN” nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në këtë nen.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, germa (d) dhe nenit 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “Rapiscan Systems ICN” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 319, datë 13.06.2014 “ Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”, si të pabazuar në ligj dhe prova.
2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 319, datë 13.06.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij Vendimi ndërmarrjes “Rapiscan Systems ICN”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCES

Servete GRUDA

(_____)
Anëtar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)
Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)
Zv/Kryetar

Lindita MILO(LATI)

KRYETAR